



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR - PASQYRË

Shqyrtimi i Shtatë i tarifës së Energjisë Elektrike

SHTE7 (2013-2017)

22 Mars 2013

Përmbajtja

1	Përmbledhje ekzekutive	2
2	Hyrje.....	4
3	Kohëzgjatja e kontrolleve	4
4	Ndryshimet në periudhën e ardhshme të kontrollit	5
4.1	Investimet e ardhshme në Gjenerim	5
4.2	Taksa për shfrytëzim të linjitit.....	5
4.3	Bilansi i energjisë dhe importet	5
4.4	Privatizimi i Distribucionit dhe i Furnizimit të KEK-ut	6
4.5	Reflektimi i kostos	6
5	Zhvillimi i MAR-eve.....	7
6	MAR – Ndryshimet dhe komponentët	7
6.1	Ndryshimet në SHTE6.....	7
6.2	Alokimi i kostove të administrates qendrore të të licencuarve	7
6.3	Rregullimet e ZRRE-së në Capex e Opex	8
6.4	Mesatarja e ponderuar e Kostos së kapitalit (WACC)	9
6.5	Faktorët e efikasitetit.....	9
7	Vlerësimpërfundimtar i MAR-it.....	10
7.1	MAR-i përfundimtar	11

1 Përmbledhje ekzekutive

Zyra e Rregullatorit për Energji ZRRE ka përfunduar Vlerësimin e vet përfundimtar për të hyrat maksimale të lejuara (MAR) për te licencuarit e rregulluar të energjisë elektrike. Në përcaktimin e MAR-it, ZRRE ka zbatuar dispozitat e legjislacionit primar të sektorit të energjisëdhe Rregullat e veta të përcaktimit të çmimeve. Ky dokument prezanton propozimet përfundimtare të ZRRE-së për shqyrtimin e shtatë të tarifës së energjisë elektrike (SHTE7).

ZRRE propozon që MAR të përcaktohet për periudhën pesë vjeçare për transmisionin dhe distribucionin, katër vite për prodhimin e rregulluar, dhe për një vit për furnizusinn publik.

Pas konsultimit për MAR-in e përkohshme, ZRRE do të merr vendimin përfundimtar. Të licencuarit pastaj do të propozojnë tarifa në përputhje me MAR përfundimtar, të cilët do të hyjnë në fuqi më 1 prill 2013.

Kompanitë kanë dhënë propozimet lidhur me nivelet e nevojshme të shpenzimeve kapitale dhe operative për periudhën rregullative. ZRRE i ka shqyrtuar këto me kujdes me ndihmën e konsulentëve të inxhinerisë. Për KOSTT-in, nivelet e propozuara të shpenzimeve kapitale (capex) janë arsyetuar në mënyrë adekuate, dhe ZRRE propozon që këto t'i lejojë në tërësi. Në rastin e KEK-ut, ZRRE konstaton se një numër i konsiderueshëm i investimevetë propozuara për mihje dhe gjenerim nuk janë të arsyetuar në mënyrë adekuate. Në përgjigje të konsultimit të Vlerësimi të Përkohshëm të ZRRE-së të lëshuar më 8 janar, KEK-u ka ofruar të dhëna të mjaftueshme për të dëshmuar se këto projekte janë në përgjithësi të domosodshme dhe të qëlluara. Kostoja dhe koha e këtyre investimeve, në disa raste, mbetet e pasigurtë. ZRRE-ja ka pranuar këto investime dhe ka bërë lejimin për investime. Lejimi i plotë do të përcaktohet gjatë kontrollit të ardhshëm kur KEK-u është në pozitë të ofrojë çmime të besueshme të kontratave për punët e nevojshme.

Ndryshimet e ZRRE-së në I. Kapitale sipas të licencuarve	Parashikimet e kompanisë €m	Vlerësim i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Mihja	162	106	-35%
KEK Gjenerimi A	66	58	-12%
KEK Gjenerimi B	56	44	-21%
KOSTT	120	120	0%
OSSH	114	107	-6%
FPEE	2	2	0%

Ngjashëm, kostot operative propozohet të ulen për të gjithë të licencuarit:

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

Ndryshimet e ZRRE-së në Opex sipas të licencuarve	Parashik. i kompanisë €m	Vlerësimi i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Miniera	191.5	150.6	-21%
KEK Gjenerimi A & B	163.9	118.0	-28%
KOSTT	61.6	34.2	-44%
OSSH	87.0	80.4	-8%
FPEE	71.5	62.0	-13%

Për të stimuluar kompanitë që të identifikojnë mënyra për kursime të kostove gjatë periudhës rregullative, ZRRE propozon të aplikoj faktorët e efikasitetit të cilët do të aplikohen për kostot operative të të licencuarve çdo vit. Për periudhën e parë rregullative ZRRE propozon që të aplikohet një faktor efikasiteti prej 4% për Mihjen, Gjenerim dhe KOSTT-in. Për OSSH-në, faktorët janë të paraçaktuar nga ZRRE në shkurt të vitit 2012 në 0% për tre vitet e para të periudhës rregullative. ZRRE propozon që faktori prej 5% të aplikohet për dy vitet e fundit të periudhës rregullative të OSSH-së.

WACC (mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit) paraqet koston e pritur të financimit të investimeve nga të licencuarit. WACC për Distribucionin dhe Furnizimin e KEK-ut ishte fiksuar në 12% (real) në vendim të Bordit në shkurt të vitit 2012. WACC-u për të licencuarit e tjerë llogaritet si mesatare e ponderuar e kthimit të vlerësuar në ekuitet dhe koston së realizuar të borxhit afatgjatë për çdo të licencuar, i cili varion prej 4.66% për mihje deri në 5.22% për gjenerim.

Marrë së bashku, vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për MAR iu lejon të licencuarëve që të vazhdojnë të investojnë në sistemin e energjisë elektrike mbi nivelet e investuara në vitet e kaluara. Tabela në vijim tregon MAR-in total përfundimtar gjatë periudhës rregullative .

		Vlerësimi përfundimtar				
		2013	2014	2015	2016	2017
KEK Mihja	€m	87.8	88.0	89.0	89.0	83.7
KEK Prodhimi (për. linjitit)	€m	60.7	61.0	61.1	61.1	58.9
Kostot tjera të blerjes neto të energjisë	€m	13.8	18.4	19.8	19.7	38.7
KOSTT OST + OT (përveç humbjeve)	€m	14.1	14.8	15.7	16.8	18.0
KEDS OSSH (përveç humbjeve)	€m	33.1	34.1	36.9	38.8	40.5
KEDS FPEE (përveç blerjeve të rrymës)	€m	15.0	32.9	30.9	31.3	32.3
Gjithsej	€m	224.6	249.2	253.5	256.7	272.0

Të hyrat e paraqitura në tabelen më lartë, për vitin 2017, për divizionin e Minjeres dhe Gjenerim nuk janë të përcaktuara me Vendim.

2 Hyrje

Në shkresën e datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja paralajmëroi fillimin e Shtatë të Shqyrtimit e Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTe7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyra maksimale të lejuara të të licencuarëve për periudhë shumë vjeçare. Ligji përcakton që të ardhura maksimale të lejuara të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara. Për të vlerësuar nëse të hyrat e lejuara janë adekuate, ZRRE duhet të vlerësojë me kujdes kostot e parapara të të licencuarëve dhe të bindet se propozimet e tyre janë të arsyeshme dhe të qëlluara. Të licencuarit janë të obliguar ligjrisht që ZRRE-së t'i ofrojnë të gjitha të dhënat të cilat ZRRE i konsideron të nevojshme për këtë analizë. Të licencuarve iu është kërkuar që aplikacionet fillestare t'ia prezantojnë ZRRE-së dhe opinionit publik më 3 shtator. Që nga kjo datë, ZRRE ka punuar për së afërmi me të licencuarit për të qartësuar aplikacionet fillestare. Të licencuarit që atëherë kanë parashtruar të dhëna dhe arsytetime domethënëse shtesë dhe i janë përgjigjur Vlerësimit të Përkohshëm të ZRRE-së më 8 janar me argumente dhe të dhëna shtesë.

ZRRE dëshiron t'u falënderohet të licencuarëve për pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e shqyrtimit deri më tani. Kjo i ka mundësuar ZRRE-së dhe konsulentëve të saj që të vlerësojnë natyrën dhe përmasat e kostove të të licencuarve, dhe parashikimet e tyre për periudhën e SHTe7 si dhe të bëjë Vlerësimin përfundimtar mbi aplikacionin e të licencuarve për të hyra të lejuara.

Ky dokument është vlerësimi përfundimtar përmbledhës për të gjithë të licencuarit i cili përfshinë komponentet kyçe të cilat e përbëjnë çmimin total të energjisë elektrike. Dokumenti gjithashtu përshkruan qasjen dhe pozitën e ZRRE lidhur me një numër të çështjeve më të gjëra që prekin të gjithë licencuarit. Krahas këtij dokumenti, ZRRE ka publikuar vlerësimet e detajuara për të hyrat e lejuara të secilit të licencuar Kohëzgjatja e kontrolleve

Rregullat e ZRRE-së për përcaktimin e çmimeve e përcaktojnë kohëzgjatjen e kontrolleve të të hyrave për periudhat e rregulluara për çdo të licencuar si në vijim:

- 5 vjet për prodhimin e rregulluar, 5 vjet Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- 1 vit për furnizuesin publik të energjisë elektrike (FPPE)

Pritjet aktuale janë që, pas heqjes nga operimi (dekomisionimi) të TC Kosova A dhe lëshimit në funksion të Termocentralit Kosova e Re (TCKR), do të jetë e domosdoshme që Kosova B të nxirret nga shërbimi për një periudhë më të gjatë për rehabilitime të zgjeruara, përfshirë kthimin e mundshëm në operim. Pasi që nuk ka ndonjë siguri lidhur me datën e një rehabilitimi të tillë, shtrirjen apo koston dhe KEK-u nuk ka mundur të ofrojë të dhëna për këtë, ZRRE e konsideron të duhur që të përcaktojë këtë kontroll fillestar shumë vjeçar të tarifës për prodhim për një periudhë prej katër viteve prej 2013 – 2016. Kjo mundëson përcaktimin e një kontrolli të ri prej 2017 e tutje kur nevojat për investim në TC Kosova B si dhe gjendja e ardhshme me furnizim pas heqjes nga funksioni të TC Kosova A të bëhet më e qartë. Ky ndryshim gjithashtu ka përparësinë sepse lejon edhe ndarjen e periudhave të ardhshme të kontrollit të çmimeve në faza ashtu që nuk është e domosdoshme që të rishqyrtohet kontrolli i të gjithë të licencuarve për një herë. Për të lehtësuar barrën e ndërlidhur me përcaktimin e

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

kontrollit shumë vjeçar të të hyrave në të ardhmen, Rregulla për përcaktimin e çmimeve ka paraparë një periudhë kalimtare para hyrjes në fuqi të këtyre kohëzgjatjeve në mënyrë që të ndajë në faza periudhat e shqyrtimeve të ardhshme.

Format raportuese të ZRRE-së i kanë obliguar të licencuarit që të ofrojnë të dhënat e parashikimit prej 2013 deri në fund të vitit 2017. Këto parashikime i kanë lejuar ZRRE-së që të kuptojë kahjen e mundshme të kostos së tërë zinxhirit të furnizimit gjatë tërë periudhës pesë vjeçare. Mirëpo, për përcaktimin e kontrollit të të hyrave MAR, ZRRE do të pasojë dispozitat e Rregullit për përcaktimin e çmimeve. Prandaj, kontrolli për biznesin e prodhimit të KEK-ut fillon më 1 prill 2013 dhe zgjat deri më 31 dhjetor 2016. Kontrollat për Operatorin e Sistemit të Distribucionit (OSSH-së) dhe për Operatorin e Sistemit dhe të Tregut hyjnë në fuqi më 1 prill 2013 por zgjasin deri më 31 dhjetor 2017.

3 Ndryshimet në periudhën e ardhshme të kontrollit

Tarifat shumë vjeçare do të mbulojnë një periudhë kohore gjatë së cilës sektori i energjisë elektrike do të pësojë ndryshime të mëdha, disa prej të cilave mund të kenë ndikim në koston e energjisë elektrike në vitet e ardhshme. Këta faktorë janë të përshkruar më poshtë, krahas qasjes indikative të ZRRE-së për secilin rast.

3.1 Investimet e ardhshme në Gjenerim

Qeveria në Strategjinë e Energjisë propozon dy fusha të rëndësishme të pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e prodhimit dhe atë: në ndërtimin e një termocentrali të ri me djegie tërëgjilje, "Kosova e Re", si dhe rehabilitimi i TC Kosova B (njësit B1 dhe B2) për t'i vënë njësit në përputhje të plotë me kërkesat mjedisore të BE-së. Strategjia parashikon edhe mbylljen e njësitëve të Kosovës A. Edhe pse fillimisht është pritur të jetë një transaksion i kombinuar, Qeveria njoftoi kohë më parë se tenderët për ndërtimin e Kosovës së Re dhe rehabilitimin e Kosova B do të jenë të ndarë.

3.2 Taksa për shfrytëzim të linjtit

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një vendim për rritjen e taksës për shfrytëzim të linjtit nga [0.27] cent për ton në 3 € për ton, duke filluar nga 1 janari 2013. ZRRE-ja i është drejtuar me shkrim Qeverisë për të shprehur shqetësimin e ndikimit të kësaj rritje në faturat e konsumatorëve. Efekti i kësaj rritjeje të taksës së linjtit është shumë i madhe.

Në shqyrtimin e fundit të gjashtë të tarifës së energjisë elektrike (SHTE6), ZRRE ka përfshirë një lejim për koston e rritur të furnizimit me linjit për këtë periudhë, e cila duhet të shpërndahet gjatë 12 muajve të periudhës së kontrollit 2012-2013, duke e zbutur me këtë rritjen e çmimit. Çmimet e energjisë elektrike do ta ndejnë efektin e plotë të rritjes së taksës për linjit më 1 prill 2013.

3.3 Bilansi i energjisë dhe importet

Kërkesa për energji dhe disponueshmëria vendore e energjisë janë shtytës kyç të çmimeve të ardhshme të energjisë elektrike. Për qëllime të këtij rishqyrtimi, ZRRE ka punuar me të licencuarit për të azhurnuar Balilancën e Energjisë së Kosovës për pesë vitet nga 2013 dhe kjo është dhënë në tabelë në vazhdim.

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

Tabela a

Bilansi i energjisë 2013 (i thjeshtëzuar)		Aktuale		Vlerësimi përfundimtar			
		2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shitjet në distribucion	GWh	3,018.86	3,252.43	3,434.02	3,585.97	3,718.02	3,826.87
Humbjet në distribucion	GWh	1,539.50	1,227.50	1,108.33	1005.5414	894.9083	778.26898
	%	33.77%	27.40%	24.40%	21.90%	19.40%	16.90%
Furnizimet e pafaturuar	GWh	210.024	212	220	230	240	250
Shitjet në transmision	GWh	473.07	621.9	621.9	621.9	621.9	621.9
LOMAG dhe konsumi i KEK-ut	GWh	117.658	295	330	330	330	330
Humbjet në transmision	GWh	109.028	111.1863	112.3489	113.1949	113.1293	107.2859
	%	1.88%	1.80%	1.80%	1.80%	1.80%	1.80%
Eksportet	GWh	371.316	492	451	440	403	84
GJITHSEJ KËRKESA	GWh	5,839.46	6,212.02	6,277.60	6,326.61	6,320.96	5,998.33
Gjenerimi I kyqur në shpërndarje	GWh	30.705	35	36	38	36	38
Prodhimi I kyqur ne transmision	GWh	5,283.01	5,672.00	5,688.00	5,720.00	5,732.00	5,265.00
Importet	GWh	525.739	505.01737	553.60481	568.608	552.95863	695.32781
GJITHSEJ FURNIZIMI	GWh	5,839.46	6,212.02	6,277.60	6,326.61	6,320.96	5,998.33

3.4 Privatizimi i Distribucionit dhe i Furnizimit të KEK-ut

Në tetor 2012, Qeveria e Kosovës dhe konzorciumi Çalik-Limak nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së divizionit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të furnizuesit publik të energjisë elektrike të KEK-ut. Bizneset do të barten në pronësi dhe kontroll të konzorciumit më 3 maj 2013, pasi të jenë përmbushur të gjitha kushtet.

Në aplikacionet e veta, KEK-u ka bërë me dije se pikësynimi i parë i planit të tyre të investimit është që të shenjëstrojë investimet kapitale në pjesët me performancë më të dobët të rrjetit të distribucionit. ZRRE nuk pret që pronari i ri i biznesit të devijojë dukshëm nga kjo qasje e synuar aktuale e KEK-ut. Mirëpo, nëse investitori dëshiron të rishqyrtojë projektet fillestare, atëherë investitori duhet të bindë ZRRE-në se plani alternativ i investimeve siguron përfitim të barazvlershëm apo më të madh për konsumatorët. Në atë rast ZRRE do të azhurnojë MAR-in dhe RAB-in e të licencuarve në Shqyrtimin e ardhshëm Periodik

3.5 Reflektimi i kostos

Legjislacioni i BE-së dhe i Kosovës kërkojnë eliminimin e ndër-subvencioneve përbrenda tarifave të energjisë elektrike. Për të përmbushur këtë kërkesë, ZRRE, gjatë aprovimit të tarifave, duhet të sigurohet që ata të ecin në drejtim të pasqyrimin të plotë të kostos.

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

Duke marrë parasysh shtytësit e tjerë kryesor të kostos, dhe në veçanti përfshirjen e rritjes së plotë të taksës për shfrytëzim të linjitet në tarifa, ZRRE beson se ri-balancimi i tarifave duhet të bëhet gradualisht gjatë periudhës së plotë të kontrollit të çmimit.

Edhe pse ribalansimi i tarifave për të larguar ndër-subvencionimin do të duhej të kishte një ndikim pozitiv në koston e bërjes së biznesit në Kosovë dhe forcimin e ekonomisë së vendit, kjo duhet të bëhet në mënyrë që siguron mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Pasi që çështjet e mbrojtjes sociale janë në kompetencë të Qeverisë, ZRRE do të kërkoj Ministrinë përkatëse që të marrin parasysh mbështetje shtesë të targetuara financiare për të mbrojtur konsumatorët në nevojë.

4 Përcaktimi i MAR

ZRRE ka për obligim të përcaktoj të hyrat maksimale të lejuara (MAR) për çdo divizion të rregulluar të KEK-ut dhe KOSTT-it. Rregullat për përcaktimin e çmimeve për secilin biznes të licencuar përcakton saktësisht se cilat kosto janë të lejuara për çdo veprimtari të rregulluar. Duke qenë se secila kompani ka më shumë se një licencë, procesi gjithashtu i kërkon ZRRE-së të shqyrtojë alokimin e kostove qendrore, siç janë ato të zyrës kryesore, të çdo divizion i licencuar. Kostoja e përgjithshme e furnizimit të energjisë elektrike do të jetë shumica e të gjithë MAR-ve, ndërsa tarifa e përgjithshme përcaktohet për të mbuluar atë shumë nga kategoritë e ndryshme tarifore.

Pjesa në vijim jep llogaritjen përfundimtare të ZRRE-së të kostove të lejuara për çdo Divizion të licencuar.

5 MAR – Ndryshimet dhe komponentët

5.1 Ndryshimet në SHTE6

Periudha kalimtare një-vjeçare (SHTE6) hyri në fuqi më 1 prill 2012 për të gjithë të licencuarit, mirëpo tarifat kanë filluar të aplikohen nga 1 qershori i po këtij viti. Në përcaktimin e MAR-it përfundimtar, ZRRE ka bërë pershtatje për të pasqyruar vlerat përfundimtare të të të licencuarve për vitin 2012. Mirëpo, në disa raste, të licencuarit nuk ishin në gjendje të arsyetojnë nivelin e shpenzimeve të tyre për vitin 2012. Në këtë instance, ZRRE ka përdorur vlera historike si një udhërrëfyes për përcaktimin e nivelit të parashikuar të shpenzimeve.

5.2 Alokimi i kostove të administratës qendrore të të licencuarve

Në aplikacionet e tyre të kostove të parashikuara, kompanitë kanë prezantuar kostot e tyre operative në disa kategori: shpenzimet e pagave, energjisë elektrike dhe kostot komunale, të mirëmbajtjes, materialeve dhe të furnizimeve, dispozitave për çështje ambientale, shpenzimeve të tjera operative dhe shpenzimeve interne. KEK-u dhe KOSTT-i kanë plotësuar formatet e raportimit në mënyra paksa të ndryshme. Mirëpo, nga aspekti rregullativ, të gjitha këto kosto duhet t'iu alokohen aktiviteteve të licencuara në mënyrë që ato të mund të mbulohen përmes MAR-ve përkatëse. Prandaj ZRRE ka përshtatur kostot e aplikacioneve të të licencuarve për administratën qendrore. Për të bërë këtë

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

pershtatje, ZRRE ka shfrytëzuar ndarjen e KEK-ut për vitin 2012, dhe i ka aplikuar këto për çdo vit të SHTE7.

5.3 Propozimet e ZRRE-së për Capex e Opex

Në harmoni me legjislacionin primar dhe me Rregullën për përcaktimin e çmimeve, të licencuarit mund t'i mbulojnë shpenzimet e tyre operative dhe kapitale, kur këto janë arsyetuar si duhet, dhe ku nivelet e koston janë konstatuar si të arsyeshme. Mbulimi i shpenzimeve kapitale nënkupton kostot e zhvleresimit të gjitha asetëve dhe kthimit në kapital për asetet e financuara komercialisht. Për qëllime të këtyre vlerësimeve përfundimtare, ZRRE ka pranuar në masë të madhe propozimet e të licencuarve për investime për periudhën rregullative. Për KOSTT-in, ZRRE konsideron se projektet e propozuara kapitale janë arsyetuar në mënyrë adekuate dhe janë rezultat i një procesi të matur dhe të qëlluar të planifikimit. Në rast të KEK-ut, ZRRE konstaton se një numër i madh i investimeve të propozuara për mihje dhe gjenerim nuk janë arsyetuar sa duhet. Në përgjigje të konsultimit për Vlerësimin e Përkohshëm të ZRRE-së të lëshuar më 8 janar, KEK-u ka ofruar të dhëna të mjaftueshme për të dëshmuar se këto projekte në përgjithësi janë të domosdoshme dhe të qëlluara. Kostoja dhe koha e këtyre investimeve, në disa raste është ende e pasigurtë. Në këto raste, ZRRE-ja ka pranuar investimet dhe ka lejuar një pjesë të investimeve. Lejimi i plotë do të përcaktohet gjatë kontrollit të ardhshëm kur KEK-ut të jetë në pozitë të ofrojë çmime të besueshme të kontratave për punët e nevojshme.

Tabela b (e azhurnuar)

Ndryshimet e ZRRE-së në I. Kapitale sipas të licencuarve	Parashikimet e kompanisë €m	Vlerësim i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Mihja	162	106	-35%
KEK Gjenerimi A	66	58	-12%
KEK Gjenerimi B	56	44	-21%
KOSTT	120	120	0%
OSSH	114	107	-6%
FPEE	2	2	0%

Në aspektin e shpenzimeve operative, ZRRE-ja ka shqyrtuar dhe rregulluar nivelet e koston operative të propozuara nga të licencuarit. Për çdo të licencuar, ZRRE-ja ka hequr rritjet në nivelet e pagave mbi normën e përgjithshme të inflacionit siç ishte propozuar nga kompanitë. Rregullimet përkatëse në nivelet e përgjithshme të shpenzimeve operative janë të detajuara në raportet individuale për secilin të licencuar dhe janë përmbledhur më poshtë.

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

Tabala c

Ndryshimet e ZRRE-së në Opex sipas të licencuarve	Parashik. i kompanisë €m	Vlerësimi i ZRRE-së €m	Ulja %
KEK Miniera	191.5	150.6	-21%
KEK Gjenerimi A & B	163.9	118.0	-28%
KOSTT	61.6	34.2	-44%
OSSH	87.0	80.4	-8%
FPEE	71.5	62.0	-13%

5.4 Mesatarja e ponderuar e Kostos së kapitalit (WACC)

ZRRE ka përcaktuar mesataren e ponderuar të Kostos së kapitalit (WACC) bazuar në Vendimet ekzistuese të Bordit, vlerësimet paraprake të Kthimit të nevojshëm për Ekuitet, koston aktuale të financimit të borxhit dhe nivelin aktual të leverazhit (*gearing*) (norma borxh/ekuletet të cilat i referohen kufizimeve të leverazhit (*gearing* të dhënë në diskutimet e mëhershme të ZRRE-së në lidhje me WACC).

ZRRE fillimisht ka supozuar një kthim komercial për ekuitet për të gjitha kompanitë e rregulluara në këtë sektor. ZRRE më tutje ka kërkuar udhëzime nga Qeveria lidhur me nivelin e kthimit për ekuitet, të cilën qeveria mund ta synojë si pronare e vetme e kompanive publike. Prandaj ZRRE-ja e ka përdorur këtë kthim për ekuitet gjatë vlerësimit të WACC-ut për kompanitë publike.

Kalkulimet e WACC-ut, të shprehur në terma reale janë përmbledhur në tabelën vijuese:

Tabala e

Vlerësimet e ZRRE-së për WACC për të licencuarit (reale)	KEK Mihja	KEK Gjenerimi	KOSTT
Kostoja e ekuitetit pas tatimeve	5.5%	5.5%	5.5%
Kostoja e ekuitetit para tatimeve	6.1%	6.1%	6.1%
Kostoja e borxhit	4.0%	4%	4%
Gearing*	0.70	0.40	0.40
WACC	4.66%	5.22%	5.07%
* Ilogaritur si borxh / borxh + ekuletet			

5.5 Faktorët e efikasitetit

Faktorët e efikasitetit aplikohen gjerësisht në praktika rregullative për të stimuluar funksionim më efikas dhe për të ofruar kualitet për konsumatorët. Rregullat e ZRRE-së për përcaktim të çmimeve e obligojnë ZRRE-në që të përcaktojë Faktorët e efikasitetit të cilët u aplikohen kostove operative dhe

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

të mirëmbajtjes. Rregullat e përcaktimit të çmimeve ofrojnë udhëzime se si ZRRE përcakton faktorët. Në veçanti, duhet të merren parasysh kostot historike dhe të parashikuara si dhe cilësinë e shërbimeve. Një përcaktim i tillë duhet të krahasojë koston e energjisë elektrike dhe efikasitetin si në Kosovë ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Duke përcaktuar një faktor tjetër efikasiteti përveç zeros, MAR-et përshtaten automatikisht në çdo vit të kontrollit, si për inflacion ashtu edhe për atë përqindje të faktorit. Faktori pozitiv i efikasitetit do të ulte të hyrat në kuptimin real, faktori negativ do të lejonte rritjen e tyre në kuptimin real. Këto faktorë definojnë në çdo shqyrtim periodik, dhe zgjasin gjatë tërë periudhës së shqyrtimit të tarifës shumë-vjeçare (TSHV). ZRRE propozon përcaktimin e një faktori të vetëm të efikasitetit për çdo të licencuar i cili do të përfaqësonte fitimet e pritura nga një operator efikas. Duhet të ceket se për Distribucionin dhe Furnizimin në KEK, Faktori i efikasitetit është para-caktuar me Vendimin e Bordit të ZRRE-së në shkurt të vitit 2012.

Përcaktimi i faktorëve të tillë të efikasiteti nuk është rezultat i llogaritjes, por i një gjykimi të informuar bazuar në informata në dispozicion. Në aspektin praktik, aktualisht nuk ka krahasues lokal. Shikuar ndërkombëtarisht, ZRRE ka shqyrtuar praktikatat më të mira në aplikimin e rregullimit me stimulim dhe ka marrë parasysh studimet e produktivitetit në BE.

Përvoja ndërkombëtare sugjeron se kompanitë publike mund të bëjnë fitime më të mëdha të prodhimit në vitet e hershme të vënies në zbatim të faktorit të efikasitetit. Studimi i ZRRE-së duke u bazuar në praktikatat ndërkombëtare ka dhënë vlera tipike në vargun prej 0% deri +4%.

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së tregon sektori i energjisë elektrike në Kosovë duket të mos jetë jashtëzakonisht joefikas në krahasim me operatorët të cilët kryejnë funksione të ngjashme gjetiu në rajon. Megjithatë, ZRRE konsideron se përmes rritjes së efikasitetit, kompanitë mund të arrijnë kursime domethënëse. Në propozimin e faktorëve në vijim, ZRRE iu lë kompanive të identifikojnë se ku mund të bëhen këto kursime

Tabela f

Faktorët e efikasitetit të propozuar nga ZRRE	2013	2014	2015	2016	2017
Mihja	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	n/a
Gjenerimi	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	n/a
KOSTT	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%
OSSH & FPEE	0.00%	0.00%	0.00%	5.00%	5.00%

6 Vlerësimi përfundimtar i MAR-it

Kjo pjesë e Raportit ofron një përmbledhje të MAR-eve e përkohshëm për çdo të licencuar, duke marrë parasysh propozimet e ZRRE-së dhe komponentët e përshkruara në pjesën 6 më lartë.

Vlerësimipërfundimtar - Pasqyrë

6.1 MAR-i përfundimtar

Tabela në vijim paraqet vlerësimin e ZRRE-së për MAR-in e çdo aktivitet të licencuar. Edhe pse ZRRE nuk e përcakton MAR-in për Mijet , i njëjti vlerësim sikurse tek gjenerimi duhet të bëhet edhe për mihjen në mënyrë që të përcaktohet kostoja e supozuar e furnizimit me linjit.

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për të licensuarit i nënshtrohen azhurnimeve vjetore sipas Rrregullave të Çmimeve të aprovuara nga ZRRE.

Rezultatet janë dhënë këtu në një format të krahasueshëm për lehtësi interpretimi.

Tabela g

		Vlerësimi përfundimtar				
		2013	2014	2015	2016	2017
KEK Mihja	€m	87.821	88.001	89.005	88.955	83.663
KEK Gjenerimi (për. linjtit)	€m	60.747	61.018	61.138	61.141	58.893
Kostot tjera të blerjes neto të energjisë	€m	13.808	18.401	19.847	19.700	38.685
KOSTT OST + OT (përveçhubmjeve)	€m	14.135	14.763	15.707	16.846	18.016
KEDS OSSH (përveç humbjeve)	€m	33.113	34.110	36.913	38.781	40.527
KEDS FPEE (përveç blerjeve të rrymës)	€m	14.974	32.909	30.935	31.267	32.264
Gjithsej	€m	224.6	249.2	253.5	256.7	272.0

Nga tabela shihet një ndryshim i madh i kostove të FPEE-së në mes të vitit 2013 dhe viteve tjera, i cili rrjedhë për shkak të agjustimeve për Import, Eksport dhe për vonesën e hyrjes në fuqi të vendimit për tarifa të vitit 2012, e të cilat duhet të bartën në vitin 2013. Vlera neto e këtyre agjustimeve është € -17.9m.